



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:048015 C. nr. 1463/2024
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05517329

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson S.K. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – DKA-së, me objekt kontesti kompensimin e shujtës, me vlerë të kontestit 402.00 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 28 Mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. MIRATOHETT PJESËRISHT, si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.K. nga Prizreni, DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të shujtave ditore për 183 ditë pune gjatë periudhës kohore nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, t’ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 366.00 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë me datë 11.03.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesës paditëse për kompensimin e shujtave në shumën prej 36.00 (tridhjetë e gjashtë euro), përtej shumës së gjykuar si në dispozitivin nën I, si e pa bazuar.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 (njëqind e njëzet e katër) euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi F.K. përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me datë 11 Mars 2022, ka parashtruar padi, të cilën me padi e kanë precizuar me datën 21 Prill 2022 në aspektin subjektiv, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me vlerë të kontestit 402 (katërqind e dy) euro.

Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se e paditura përkundër obligimeve përkatësisht fitimit të së drejtës, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektivë e Arsimit pasi që e

paditura nuk I ka përmbushur obligimet I ka që pas administrimit të provave dhe analizimit të thënieve në padi, ta aprovojë kërkesë padinë e paditësit F.K. si e bazuar dhe të detyrohet e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) që paditësit të ja bëjë kompensimin e ushqimit ditor nga 2 euro në ditë për ditët e pranisë në punë prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2021, me kamat ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë e gjer në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej shtat (7) ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.7320/2022 të datës 22.02.2024, e ka kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së para për rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata përmes vërtetimit me numër të referencës 48 të datës 02.02.2022, të lëshuar nga ana e të paditurës, ka vërtetuar faktin se paditësi F.K. është në marrëdhënie pune në Shkollën e Mesme të Ulët ‘Hysen Rexhepi’ në Prizren, nga data 09.10.2001, dhe vazhdon të jetë. I njëjti për vitin 2021 duke filluar nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021 ka 183 ditë pune.

Nga leximi i kërkesës e datës 21.04.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi përmes të autorizuarit të tij, nga e paditura ka kërkuar që në kohë sa ma të shkurtër dhe të arsyeshëm të sjell vërtetimin për paditësin për vitin 2021 për ditët e vijueshmërisë në punë, lidhur me kompensimin e shujtave.

Në bazë të listës së pagave, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi F.K. realizon pagën bazë në shumën prej 421.00 euro.

Vërtetimin e lartcekura, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e cila edhe si e tillë është e pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimi i lëshuara nga ana e SH.F.M.U. “Hysen Rexhepi”, në Prizren, si prova me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditësit, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga e cila vërtetoi faktin se për vitin 2021, nga data 01.01.2021 e deri më datë 31.12.2021, vijueshmëri në punë ka pas gjithsej 183 ditë pune.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitivin 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se “*Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i*

cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si mësimdhënës t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësin, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për paditësin F.K. 183 ditë pune, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata ka vendosur si në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadiës së paditësve për kompensimin e shujtave në shumën prej 36.00 euro, gjykata ka vendosur si në pikën nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi në mungesë të provave relevante për t’i vërtetuar faktet vendimtare, gjegjësisht në bazë të vërtetimeve të lëshuara nga e paditura me numër 48/2023 të dates 02.02.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi Faton Kabashi, për vitin 2021 duke filluar nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, ka punuar 183 ditë pune, e jo 201 ditë pune, sa ka pretenduar paditësi në precizimin e kërkesëpadiës.

Në këtë çështje kontestimore gjykata i referohet nenin 7.1 të LPK-së ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”* Edhe në nenin 319.1 të LPK-së rezulton kërkesa që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.*

Gjykata me rastin e vendosjes për refuzim të pjesshëm të kërkesëpadiës jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së, lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e

Numri i lëndës: 2022:048015
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05517329

datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 20.00 euro, gjithsej shumë prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.1463/24, datë 28 Mars 2024

B.profesional
Irir Sërtollaj

Gjyqtari
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.